

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 09.1012018	Numri i seancës për këtë çështje: 1 (një)
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqiptari (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK). Objekti: Procesi për rivlerësimin kalimtar të zj. Arta Vorpsi, Këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese.		
Emri i subjektit të rivlerësimit	Znj.Arta Vorpsi		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca degjimore për subjektin e rivlerësimit, zj.Arta Vorpsi u zhvillua në datën 09.11.2018, e cila filloi në orën e përcaktuar 10:00 deri më 10:22. Nuk pati shtyrje të seancës dëgjimore dhe as shkak ligjor që ajo të shtyhej për shqyrtim të mëtejshëm.		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Në fund të seancës dëgjimore trupi gjykues u tërhoq për marrjen e vendimit dhe shtyu seancën vetëm për shpalljen e tij në datën 12.11.2018, në përputhje me pikat 5 dhe 6 të nenit 55 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH-së"		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Tupa gjykyese (emrat)	Trupi gjykues përbëhej nga: Kryesues:Lulzim Hamitaj, Relator: Genta Tafa(Bungo), Anetar: Valbona Sanxhaktari		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Përfaqësuesi I Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit(OMN) ishte Znj.Elka Ermenkova		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Subjekti I rivlerësimit u paraqit I vetëm, pa praninë e një mbrojtësi ligjor(Avokat)		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Amilda Celami		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Në hyrje të sallës cdokush që dëshironte të ishte i pranishëm në zhvillimin e seancës duhej të paraqiste një mjet identifikimi dhe të sigurohej qetësia e pajisjeve elektronike. Numri total I të pranishmëve variante 15-20 persona.		
Media e pranishme:	Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, të pranishëm ishin gazetarë dhe operatorë të medias. Në sallë u vu re prania e vetëm një operatori(kameramani) dhe të disa gazetarëve.		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vetingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po/Jo	Nëse u vendos vetëm për një kriter, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	Gjatë shqyrtimit të seancës dëgjimore u trajtuan 3 kriteret((i pasurisë, kontrolli I figurës, vlerësimi I aftësive profesionale) të gjykimit të procesit të Vetting-ut	N/A	N/A
D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?

D1. Pasuria	Pasuria e Znj.Vorpsi përbëhej nga 1- Apartament banimi, sipërfaqe 116 m ² , me vlerë të deklaruara 2 milion leke, blerë në 14.03.2003, pasuri e krijuar si rezultat i shitjes së një sipërfaqe toke, kjo e trashëguar nga bashkëshorti i subjektit. 2. Automjetet Ford Focus prodhim i 2004, blerë në vlerën 2600 Euro. Burimi i të ardhurave u cilësua shitja e automjetit të mëparshëm (Ford Fiesta) në vlerën 2300 Euro. Subjekti nuk kishte deklaruar të ardhurat nga aktiviteti i saj profesional por Zj.Vorpsi kishte pohuar që këto të ardhura kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve	Referuar raportit të ILDKPKI-së, të dhënave të siguruar gjatë hetimit administrativ të pavarur KPK-së, dhe të dhënave të tjera të marra nga institucionet publike, prova nga vetë subjekti.	Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen djeni mbi dosjen dhe rezultatet e hetimit. Pohoi se ishte dakort lidhur me përfundimet e hetimit dhe nuk kishte pretendime dhe kundërshtime
	Subjekti nuk kishte zgjedhur avokat dhe mbrohej vetë	Mbrojtja?	
	Konfrimon se ishte dakort lidhur me përfundimet e hetimit dhe nuk kishte pretendime dhe kundërshtime	Subjekti i rivlerësimit (znj. Vorpsi)	
	Nuk u relatuan gjatë seancës ankesa nga publiku	Ankesa nga publiku?	
	Nuk kishte pyetje ndaj subjektit	Përfaqësuesja e ONM-së?	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Figurë e pastër	Referuar raportit të DSIK dhe të dhënave të siguruar nga hetimi administrativ të relatuar nga relatorja	Zj.Vorpsi konfirmon se është vënë në dijeni mbi rezultatet e hetimit dhe ka marrë në dorëzim dosjen. Shpreh dakordësi lidhur me përfundimet e hetimit
	Dakord me raportin e DSIK dhe të dhënat e relatuar nga relatorja	Subjekti i rivlerësimit (znj. Vorpsi)	
	Nuk ka ankesa nga publiku	Publiku?	
	Nuk ka pyetje nga ONM	Vëzhguesi i ONM-së?	

D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Subjekti ka aftësi të mira në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, njohuritë e saj ishin mjaft të cilat konfirmohen edhe nga angazhimet e saj akademike, njeh parimet e së drejtës, të drejtat e paleve. Në fazën e dytë të testimit në shkollën e Magjistraturës ishte vlerësuar me 145 pikë nga 200 të mundshme	Referuar relacionit të KLD-së, të dhënave të siguruar nga hetimi administrativ i KPK-së dhe rezultateve të testimit në Shkollën e Magjistraturës. në fazën e dytë ku subjekti ishte vlerësuar me 145 pikë nga 200 të mundshme. Zj.Vorpsi ka treguar cilesi të mirë në punë. Për këtë subjekt nuk kishte denoncime.	Në fjalën e saj relatorja e çështjes pohoi se ishte kaluar barra e provës subjektit të rivlerësimit. Zj.Vorpsi kishte paraqitur me shkrim pretendimet e saj. Subjekti shpreh dakordësinë për përfundimet e hetimit administrativ të KPK-së.
	Konfirmon marrjen djeni mbi dosjen dhe dokumentat provues. Shpreh dakordesi lidhur me përfundimet e hetimit	Subjekti i rivlerësimit	
	Nuk u relatuan ankesa nga publiku	Publiku?	
	Nuk ka pyetje nga ONM	Vëzhguesi I ONM-së?	
E.Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimitu paraqit e rregullt në tërësi. Subjekti nuk pati kontestime dhe kundërshtime si dhe munguan pyetje shtesë apo diskutime mbi proveshmërinë e fakteve/vlerësimeve të konstatuara nga hetimi I thelluar administrativ i KPK-së dhe OMN-së. Trupi gjykues respektoi rregullat e etikës. Subjekti I rivlerësimit kishte zgjedhur të mos kishte mbrojtës ligjor, duke u paraqitur e vetme gjatë seancës dëgjimore. Në sallën ku zhvillohej seanca dëgjimore u lejuan media, gazetarë, qytetarë të rastësishëm, përfaqësues të organizatave të shoqërive civile,familjarë të subjektit te rivlerësimit si dhe kushdo qe ishte i interesuar.		